



Vlerat dhe Etika në vendin e punës

Akademia Profesionale ELITA

Objektivat

- Kuptimi i Etikës në vendin e punës dhe Rëndësia e saj
- Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës
- Si Etika ju bën një person më të mirë?
- Dallimet etike në vendin e punës
- Morali dhe etika në vendin e punës
- Si të trajtohen çështjet etike në punë

Etika në përgjithësi - Kuptimi

Etika është kodi i përgjithshëm i sjelljes që supozohet të respektohet kur jeton në shoqëri. Qëllimi i sjelljes etike është përmirësimi i vlerës morale në shoqëri.

Fjala "Etikë" do të thotë filozofi morale ose parime morale dhe standarde të sjelljes. Etika përfshin shkencën e moralit, parimeve të moralit dhe e gjithë kjo është tërësia e vlerave që drejton sjelljen tonë.

Vlerat dhe etika në biznes

Vlerat dhe etika në shërbimin publik i referohet parimeve ose kodit të sjelljes që zbatohen çdo ditë, gjatë komunikimit dhe shërbimit ndaj publikut të gjerë.

Ajo gjithashtu përfshin individët që punojnë në një organizatë, kodin e tyre të sjelljes dhe atë të organizatës në tërësi.

Rregullat e arta të etikës së biznesit

- **Besueshmëria**
 - **Respekti**
- **Përgjegjshmëria**
- **Ndershmëria / Drejtësia**
 - **Nderimi / Integriteti**
 - **Profesionalizmi**
- **Respektimi i pronësisë dhe konfidencialitetit**

Burimet e etikës së përgjithshme

- **Kultura** - një model sjelljesh dhe vlerash që transferohen nga një gjeneratë në tjetrën
- **Feja** - Besohet se etika është një shfaqje e hyjnore, dhe kështu vendos një vijë dalluese midis të mirës dhe të keqes në shoqëri
- **Ligjet** - janë procedura dhe kode sjelljeje, që përcaktohen nga sistemi ligjor i shtetit

Burimet e etikës në Shërbimin Publik

- Rregullimi ligjor
- Kodi profesional i etikës
 - Vlerat individuale

Rregullimi ligjor

- Respektimi i lirisë dhe të drejtave të të tjerëve
- Rëndësia e të vepruarit në mirëbesim
- Rëndësia e ushtrimit të kujdesit të duhur
- Rëndësia e nderimit të konfidencialitetit
- Shmangia e konfliktit të interesit

Kodi profesional i etikës

- Urdhëri i Mjekut
- Urdhëri i Infermierit
- Urdhëri i Psikologut
- Urdhëri i Farmacisitit
- Urdhëri i Stomatologut
- Urdhëri i Veterinerit
- Urdhëri i Punonjësit Social
- etj.

Vlerat individuale

Si të merrni vendime dhe të veproni me etikë

Bëni **5 Pyetje** vetes:

- A e kam menduar, nëse veprimi që mund të ndërmarr është i drejtë apo i gabuar?
- A do të jem krenar, kur t'i tregoj familjes time, shefit tim apo një gazetari, për veprimet e mia?
- A jam i bindur se të gjithë do të vepronin, ashtu siç jam duke menduar të veprojnë?
- A do t'i shkaktojë dëm, të tjerëve apo mjedisit, vendimi im?
- A do ta shkel ligjin me veprimet e mia?

Roli i Etikës në Shërbimin Publik

Etika në Shërbimin Publik nënkupton:

ndershmërinë, përgjegjshmërinë, integritetin, ndjeshmërinë, transparencën dhe aftësinë për të kuptuar ndryshimin midis asaj që është e drejtë dhe asaj që është e gabuar.

Organet publike dhe organizata private krijojnë deklarata misioni, si një standard vlerash dhe etike, që vendosin tonin dhe karakterin e organizatës dhe për të gjithë punonjësit e saj.

Vlerat dhe Etika në Shërbimin Publik

Një Kod Vlerash dhe Etike në Shërbimin Publik:

1. Udhëheq dhe mbështet nëpunësin publik në aktivitetin e tij profesional
2. Ruan dhe rrit besimin e publikut në integritetin e Shërbimit Publik

Vlerat dhe Etika në Shërbimin Publik

Vlerat Demokratike

Shërbejnë në përputhje me ligjin, për t'i shërbyer interesit publik

- Shërbejnë dhe japin këshilla të ndershme dhe të paanshme
- Zbatojnë me besnikëri ligjet, vendimet, etj.
- Mbështesin llogaridhënien individuale dhe kolektive

Vlerat dhe Etika në Shërbimin Publik

Vlerat Profesionale

Shërbejnë me kompetencë, përsosmëri, efikasitet, objektivitet dhe paanshmëri

- Shërbejnë brenda ligjeve dhe në përputhje me neutralitetin politik
- Sigurojnë përdorimin e duhur, efektiv dhe efikas të parasë publike
- Mënyra se si arrihet qëllimi është po aq e rëndësishme sa edhe vetë arritja
- Përmirësojnë vazhdimisht angazhimin e tyre për t'i shërbyer qytetarëve
- Sigurohen që transparenca dhe konfidencialiteti të respektohen sipas ligjit

Vlerat dhe Etika në Shërbimin Publik

Vlerat Etike

Shërbejnë në çdo kohë në mënyrë të tillë që të ruajë besimin e publikut

- Sigurojnë një raport korrekt midis detyrave dhe punëve të tyre private
- Veprojnë gjatë gjithë kohës në një mënyrë që të kenë vëzhgimin dhe kontrollin më të afërt publik
- Në përmbushje të detyrave dhe përgjegjësive zyrtare, marrin vendime në interes të publikut
- Kur lind konflikt midis interesit privat dhe detyrës zyrtare të nëpunësit publik, konflikti zgjidhet në favor të interesit publik

Vlerat dhe Etika në Shërbimin Publik

Vlerat Njerëzore


Demonstrimi i respektit, drejtësisë dhe mirësjelljes në marrëdhëniet me qytetarët dhe me punonjësit e tjerë publikë

- Respekti për dinjitetin njerëzor dhe vlerën e çdo personi shoqëron gjithmonë ushtrimin e autoritetit dhe përgjegjësisë
- Trajtimi me drejtësi dhe mirësjellje motivon edhe të tjerët që t'i shfaqin këto vlera në sjelljen e tyre
- Shërbimi publik karakterizohet nga pjesëmarrja, hapja dhe komunikimi me respekt për diversitetin njerëzor
- Rekrutimi, vlerësimi dhe promovimi në Shërbimin Publik duhet të bazohet në merita

Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

- Ka 5 dimensione - ku çdo dimension shoqërohet me një vlerë përkatëse.

Kjo qasje na jep grupet thelbësore prej pesë vlerave njerëzore:



Vlerat dhe etika njerëzore në vendin e punës

Dedikimi

Punonjësit publikë që bëjnë përpjekje të singerta, pasi ka rënë dakord të bëjë më të mirën, në shërbim të publikut dhe organizatës

Integriteti

Integriteti i referohet sjelljes së ndershme, si në raport me publikun ashtu edhe me organizatën dhe veten. Kjo nënkupton edhe të qenit i singertë psh. në një raport shpenzimi

Përgjegjësia

Punonjësi publik, pritet që të veprojnë me përgjegjësi për veprimet e tyre.

Bashkëpunimi

Është e rëndësishme që punonjësit të jenë lojtarë të ekipit

Paraqitja

Veshja e duhur, Gjuha e përshtatshme në zyrë, si dhe sjellja me profesionalizëm


Si Etika ju bën një person më të mirë?

- Krijoni besueshmëri në marrëdhënie
- Siguroni kohezionin e ekipit
- Ofroni vlera për organizatën
- Ndiheni mirë personalisht

Kohezioni ekipor

- Ju bën një lojtar më të mirë të ekipit
- Siguron bashkëpunim dhe kontribut në rezultate
- Ndhmon në krijimin dhe sigurimin e një ambienti pozitiv pune

Vlera për organizatën



Ndiheni mirë personalisht

- Bëhesh një person më i mirë për veten tënde, përveç rritjes së vlerës tënde ndaj të tjerëve
- Shmang ngarkesën e fajit dhe paranojës
- Ju jep qetësi mendore, stabilitet emocional dhe aftësi për të kultivuar miqësi të qëndrueshme
- Rrit kënaqësinë tuaj në punë, dhe qetësinë, për jetën në përgjithësi

Morali dhe Etika

- Morali dhe etika shkojnë së bashku
- Ofrimi i një shërbimi etik dhe moral varet jo vetëm nga dokumentat për këtë qëllim dhe sjellja e **drejtuesve** të Shërbimit Publik, por edhe nga sjellja e **punonjësve** të organizatës